

KAPITULLI II SKEMAT E SIGURIMIT SHOQËROR SUPLEMENTAR

Deputetët

LIGJ

Nr.8097, datë 21.3.1996

PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT

*(Ndryshuar me ligjet nr.8500, datë 10.6.1999; nr.9061, datë 8.5.2003; nr.9827, datë 5.11.2007;
nr.9990, datë 15.9.2008)*

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Përkufizime

*(Riformuluar pikat 8 dhe 9 me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 1;
shtuar fjalët në pikën 9 të shkronjës “a” me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 1;
shtuar fjalët në pikën 9 të shkronjës “a” me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 1;
shtuar fjalët në pikën 9 të shkronjës “a” dhe “b” me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 1;
hequr fjalët në shkronjat “c” dhe “d” me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 1;
shtuar fjalët në pikën 8 shkronja “b” me ligjin nr.9990, datë 15.9.2008, neni 1)*

1. Me termin “Ligj për sigurimet shoqërore” do të kuptohet ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

2. Me termin “Sigurim shoqëror i detyrueshëm” do të kuptohet sigurimi sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

3. Me termin “Kushtetuese” do të kuptohet legjislacioni kushtetues.

4. Me termin “Përfitime shtetërore suplementare” do të kuptohen përfitimet që jepen sipas këtij ligji.

5. Me termin “Vite shërbimi” do të kuptohen vitet e punës së kryer në një nga funksionet që burojnë nga Kushtetuta ose një nga detyrat në administratën publike, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

6. Me termin “Aksident në shërbim” do të kuptohet ndryshimi i gjendjes shëndetësore (i njohur nga KMCAP sipas ligjit për sigurimet shoqërore), ose vdekja për shkak dhe gjatë kryerjes së funksionit a detyrës (për këto të fundit sipas përkufizimeve të dhëna në këtë nen).

7. Me termin “Pagë referuese” do të kuptohet paga e muajit më të fundit sipas legjislacionit në fuqi që zbatohet për atë funksion a detyrë. Paga referuese është bazë e llogaritjes dhe e rilllogaritjes së pensioneve suplementare dhe pagesës kalimtare.

8. Në termin “Grupi i parë” do të përfshihen:

a) Presidenti i Republikës, Kryetari i Kuvendit, Kryetari i Këshillit të Ministrave, Zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave, ministrat, Zëvendëskryetari i Kuvendit dhe të barazuar me ligj me ta, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Kryetari i Gjykatës së Lartë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit.

b) Deputetët e Kuvendit, anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, anëtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, si dhe Avokati i Popullit, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive.

9. Në termin “Grupi i dytë” do të përfshihen:

a) Sekretarët e Shtetit, zëvendësministrat, zëvendësprokurorët e Përgjithshëm, si dhe personat e tjerë të barazuar me ta, sekretarët e përgjithshëm dhe funksionarët politikë pranë Presidentit, Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrive, institucioneve qendrore buxhetore, prefekturave, këshillave të rretheve, këshillave të qarqeve bashkive dhe personave të tjerë të barazuar me ta, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe Kryetari i Arbitrazhit të Lartë Shtetëror.

b) Personat që kryejnë detyra në administratën e Presidentit, të Kuvendit, Këshillit të Ministrave, ministrive dhe institucioneve qendrore buxhetore, të Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, gjykatave të apelit, prokurorive të rretheve, prefekturave dhe të pushtetit vendor dhe personave të tjerë të barazuar me ta, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

c) Personeli drejtues ku do të përfshihen: drejtorët e drejtorive, përgjegjësit e sektorëve, si dhe personat e tjerë të barazuar me ta, në funksion dhe personat të cilët punojnë në organet drejtuese të pushtetit vendor dhe në funksione të tjera drejtuese, sipas listës së miratuar nga Këshilli i Ministrave.

d) Personeli specialist ku do të përfshihen specialistët dhe personat e tjerë të barazuar me ta në funksion dhe sipas përcaktimeve të Këshillit të Ministrave.

10. Në termin “Persona të punësuar” do të përfshihen gjithë personat që janë përcaktuar në pikat 8 dhe 9 të këtij neni.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të jepen përfitime shtetërore suplementare si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen nga sigurimi i detyrueshëm shoqëror për personat e grupit të parë dhe të dytë.

Neni 3

Personat e mbrojtur

Përfitojnë nga ky ligj personat që përcaktohen në nenin 1.

Neni 4

Financimi

Përfitimet shtetërore suplementare që jepen sipas këtij ligji financohen:

a) nga buxheti i shtetit;

b) nga kontributi që derdhin personat e punësuar.

Neni 5

(Ndryshuar neni me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 2)

Kontributet, që paguajnë personat e punësuar në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, janë:

a) 4 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të parë;

b) 3 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji;

c) 2 për qind të shumës bruto të listëpagesave për personat e grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “d” të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji.

Neni 6

Pagesa e kontributeve

Kontributet paguhen çdo muaj në fondin e sigurimit shtetëror suplementar. Afati i derdhjes është jo më vonë se fundi i muajit pasardhës.

**KREU II
SHPËRBLIME DHE PENSIONE**

**PJESA E PARË
PAGESË KALIMTARE**

Neni 7

*(Shtuar paragrafë pas paragrafit të tretë me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 2;
reformular paragrafët e parë me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 3;
reformular paragrafi i parafundit me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 3)*

Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen tri paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të parë, që përmenden në shkronjën “b” të pikës 8 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 50 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 3 vjet nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personave të grupit të dytë, që përmenden në shkronjën “a” të pikës 9 të nenit 1, pas largimit nga funksioni, u jepen dy paga mujore të funksionit dhe pas këtyre pagave marrin 40 për qind të pagës referuese, për aq kohë sa kanë punuar në funksione të tilla, por jo më shumë se 1 vit nga momenti i largimit nga ky funksion.

Personat, të cilët gjatë periudhës së përfitimit të pagesës kalimtare janë të punësuar në një funksion kushtetues, që përfshihet në këtë ligj, pas largimit nga ky funksion, do të marrin pagesë kalimtare vetëm për atë periudhë shërbimi në funksion, gjatë së cilës nuk janë trajtuar edhe me pagesë kalimtare nga funksioni paraardhës.

Periudha, gjatë së cilës personat nuk janë të punësuar dhe përfitojnë shpërblim të menjëhëshëm dhe pagese kalimtare, njihet si periudhë sigurimi për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, familjar dhe invaliditeti, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kontributi i sigurimit të detyrueshëm shoqëror për këta persona derdhet në fondin e sigurimeve shoqërore nga buxheti i shtetit.

Në rastet kur përfituesi punësohet, brenda periudhës së përfitimit të pagave të funksionit të fundit apo të pagesës kalimtare, masa e pagesës mbi pagën e re është një kompensim deri në nivelin e pagës referuese të funksionit, por në çdo rast ajo nuk mund të jetë më shumë se paga e funksionit të fundit apo pagesa kalimtare e tij.

Ky shpërblim ndërpritet në momentin që do të marrë pension pleqërie.

**PJESA E DYTË
PENSIONE SHTETËRORE SUPLEMENTARE**

Neni 8

Kushtet e përfitimit për grupin e parë

*(Shtuar fjalët në pikën 2 shkronja “a” me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 3;
shtuar paragraf pas pikës 2/b me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 4;
shtuar pika 3 në paragrafin e parë me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 4;
shfuqizuar paragrafi i fundit me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 4;
shtuar fjalët në pikën 2 shkronja “a” me ligjin nr.9827, datë 5.11.2007, neni 1)*

Kushtet për të përfituar pension suplementar sipas këtij ligji janë:

1. Pas mbushjes së moshës 55 vjeç ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë sipas ligjit për sigurimet shoqërore dhe

2. Të kenë kryer jo më pak se

a) për personat e shkronjës "a" të nenit 1, pika 8, 1 vit e gjysmë shërbim në funksion me përjashtim të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Këshillit të Ministrave, zëvendëskryetarët e Kuvendit.

b) për personat e shkronjës "b" të nenit 1, pika 8, 2 vjet shërbim në funksion.

3. Personat, të cilët nuk plotësojnë periudhën e shërbimit të parashikuar në pikën 2 të këtij neni, përfitojnë pension suplementar të reduktuar, në raport me periudhën e shërbimit në funksion apo në detyrë.

Personat, të cilët plotësojnë njërin nga kushtet e mësipërme, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.

Neni 9

Masa e pensionit

(Shtuar shkronja "c" me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 5)

Masa e pensionit shtetëror suplementar është:

a) Për grupin e parë shkronja "a", në kushtet e nenit 8, për 2 vjet shërbim 25 për qind e pagës referuese dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këto 2 vjet.

b) Për grupin e parë shkronja "b", në kushtet e nenit 8, për 2 vjet shërbim 20 për qind e pagës referuese dhe 5 për qind më shumë për çdo vit shërbim mbi këto 2 vjet.

c) për personat e pikës 3 të nenit 8 të këtij ligji, 1 për qind e pagës referuese, për çdo muaj shërbim në funksionet e përcaktuara në shkronjën "a" të pikës 8 të nenit 1 dhe 0,8 për qind e pagës referuese, për çdo muaj shërbimi në funksionet apo detyrat e përcaktuara në shkronjën "b" të pikës 8 të nenit 1.

Kjo masë pensioni nuk duhet të jetë më e madhe se

a) 60 për qind e pagës referuese për personat e përcaktuar në shkronjën "a" të grupit të parë, neni 1;

b) 50 për qind e pagës referuese për personat e përcaktuar në shkronjën "b" të grupit të parë, neni 1.

Neni 10

Kushtet e përfitimit për grupin e dytë

*(Shtuar paragraf me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 5
ndryshuar shkronja "b" me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 6)*

Kushtet e përfitimit të pensionit shtetëror suplementar sipas këtij ligji janë:

a) kanë kryer 35 vjet shërbimi në detyrë ose

b) pas arritjes së moshës për pension të plotë pleqërie ose para kësaj moshe, kur deklarohet invalid i plotë, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë.

Personat, të cilët plotësojnë njërin nga kushtet e mësipërme, duhet të kenë ndërprerë veprimtarinë ekonomike.

Neni 11

Masa e pensionit

Masa e pensionit shtetëror suplementar në kushtet e nenit 10 është:

a) për personelin drejtues të grupit të dytë sipas shkronjës "a" të pikës 10 të nenit 1, 1.5 për qind në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi;

b) për personelin drejtues të grupit të dytë, sipas shkronjës "b" dhe "c" të pikës 10 të nenit 1, 1.3 për qind në vit e pagës referuese për çdo vit shërbimi;

c) për personeli specialist të grupit të dytë, sipas shkronjës "d" të pikës 10 të nenit 1, 1 për qind në vit e pagës referuese për çdo vit shërbimi.

Pensioni shtetëror suplementar maksimal sipas këtij neni nuk duhet të jetë më i madh se 40 për qind e pagës referuese.

PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE FAMILJARE

Neni 12

Kushtet e përfitimit

Përfitojnë pensione familjare nga personi që vdes dhe që përfitonte ose kishte kushtet për pension shtetëror suplementar sipas këtij ligji, këta persona në ngarkim:

- bashkëshorti pasjetues,
- jetimi

dhe kur kanë plotësuar kushtet për pension familjar sipas ligjit për sigurimet shoqërore.

Neni 13

Masa e pensionit

(Zëvendësuar fjalët në paragrafin e parë me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 7)

Masa e pensionit në kushtet e nenit 12 është:

- a) 50 për qind për bashkëshortin pasjetues dhe
- b) 25 për qind për jetimin.

Kur nuk merret pensioni i parashikuar në shkronjën “a” të këtij neni, masa e pensionit për jetimin është vetëm 50 për qind.

Në çdo rast masa e pensionit suplementar familjar nuk mund të jetë më e lartë se pensioni suplementar që kishte ose i takonte të përfitonte mbajtësi i familjes.

Neni 14

Personat që aksidentohen në shërbim dhe deklarohen invalidë të përhershëm, sipas ligjit për sigurimet shoqërore, përfitojnë pension shtetëror suplementar në masën 40 për qind të pagës referuese, pavarësisht nga koha e punës në funksionet a detyrat sipas përkufizimeve të nenit 1.

KREU III

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 15

*(Shtuar paragraf me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 6;
shtuar fjalë në fund të paragrafit të parë me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 8)*

Vite shërbimi për efekt përfitimi nga ky ligj do të njihen vitet e punuara nga data 1 prill 1991.

Periudhë shërbimi, për efekt përfitimi nga ky ligj, pas 1 prillit 1996, do të njihet periudha, gjatë së cilës është derdhur kontribut në fondin e sigurimit shtetëror suplementar.

Kanë të drejtë të marrin përfitime shtetërore suplementare presidentët e Republikës, që kanë qenë në këtë funksion prej datës 1 prill 1991. Përfitimet e mësipërme do të jepen që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”. Efektet financiare, për pagimin e këtyre përfitimeve, të përballohen nga buxheti i shtetit.

Neni 16

Kur vitet e shërbimit nuk janë vite të plota, për efekt llogaritjeje të masës së përfitimit, do të llogariten edhe ditët ose muajt mbi këto vite. Mënyra e llogaritjes do të përcaktohet në udhëzimin që do të nxjerrë Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 17

(Ndryshuar paragrafi i parë me ligjin nr.9061, datë 8.5.2003, neni 9)

Masa e pensionit shtetëror suplementar, plus pensionin e përfituar nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Shqipërisë”, nuk mund të jetë më e madhe se 75 për qind e pagës referuese të funksionit.

a) për grupin e parë 90 për qind e pagës referuese të funksionit;

b) për grupin e dytë 80 për qind e pagës referuese të funksionit apo detyrës.

Këshilli i Ministrave është i detyruar të rritë pensionin shtetëror suplementar, në të njëjtën masë që rritet edhe paga referuese e detyrës a funksionit që ka pasur personi.

Neni 18

Pagesa e pensionit shtetëror suplementar ndërpritet kur personi zgjidhet ose caktohet në funksionet a detyrat e grupit të parë ose të dytë. Në këtë rast, pas përfundimit të shërbimit në funksion a detyrë, pensioni shtetëror suplementar do të rillogaritet.

Neni 19

(Ndryshuar neni me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 7)

E drejta për përfitim shtetëror suplementar nuk parashkruhet.

Personit, që kërkon përfitim shtetëror suplementar brenda një viti nga data që i ka lindur e drejta, i jepet ky përfitim që nga kjo datë. Në raste të tjera, përfitimi do të paguhet nga data e regjistrimit të kërkesës.

Neni 20

Pensionet shtetërore suplementare administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 21

Kërkesa

Pensionet shtetërore suplementare jepen me kërkesën e të interesuarit, i cili do të paraqesë dokumentacionin përkatës.

Kërkesa për pension paraqitet pranë organeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Dokumentet që i bashkëngjiten kërkesës, përcaktohen me akte nënligjore.

Neni 22

Pagesa e pensioneve shtetërore suplementare bëhet nga organi i caktuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Neni 23

Apelimet kundër vendimeve të përfitimit bëhen në gjykatë e cila e zgjidh çështjen përfundimisht.

Neni 24

Kur personi, që merrte ose kishte kushtet për pension shtetëror suplementar, sipas këtij ligji, deklarohet fajtor nga gjykata për krime të rënda me dashje, nuk e përfiton ose i ndërpritet përfitimi shtetëror suplementar.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 25

(Ndryshuar neni me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 8)

Personat, të cilët njëkohësisht përfitojnë shtesë ose pension të posaçëm shtetëror dhe pension shtetëror suplementar kanë të drejtë të zgjedhin pensionin më të favorshëm.

Neni 26

Personi që ka përfituar pension nga ligji për sigurimet shoqërore dhe pas datës 1 prill 1991 është në marrëdhënie pune në funksionet a detyrat e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, merr përfitimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 27

Personi, i cili, sipas ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës kundër Pushtuesve Nazifashistë”, përfiton shtesë pensioni dhe në rast se pas datës 1 prill 1991 është në marrëdhënie pune në funksionet a detyrat e përcaktuara në nenin 1 të këtij ligji, merr përfitimet e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 28

(Shfuqizuar neni me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 9)

Neni 29

(Shtuar paragraf me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, neni 10)

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe të sigurojë kushtet e nevojshme për Institutin e Sigurimeve Shoqërore për administrimin e kësaj skeme.

Ngarkohen Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Financave të nxjerrin aktin nënligjor të përbashkët, për mënyrën e dhënies dhe për pagimin e shpërblimit të menjëhershëm.

Neni 30

Ky ligj hyn në fuqi më 1 prill 1996.

Shpallur me dekretin nr.1445, datë 5.4.1996 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.13, datë 7.5.1996

Ligji nr.8500, datë 10.6.1999 shpallur me dekretin nr.2403, datë 29.6.1999 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Rexhep Meidani, botuar në Fletoren Zyrtare nr.22, datë 26.7.1999.

Ligji nr.9061, datë 8.5.2003 shpallur me dekretin nr.3828, datë 2.6.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Alfred Moisiu, botuar në Fletoren Zyrtare nr.47, datë 19.6.2003.

Ligji nr.9827, datë 5.11.2007 shpallur me dekretin nr.5514, datë 12.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi, botuar në Fletoren Zyrtare nr.152, datë 13.11.2007.

Ligji nr.9990, datë 15.9.2008 shpallur me dekretin nr.5898, datë 1.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi, botuar në Fletoren Zyrtare nr.150, datë 3.10.2008.

VENDIM
Nr.382, datë 20.5.1996

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET SHETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”

Në bazë të nenit 29 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në zbatim të pikës 5 të nenit 1 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, njihen vite shërbimi për përfitime sipas këtij ligji vitet e punës, të kryera në funksionet që burojnë nga Kushtetuta, ose në detyrat e administratës publike të përcaktuara në listën që i bashkëngjitet këtij vendimi.

II. Në zbatim të pikës 7 të nenit 1 të ligjit të mësipërm, me termin "pagë referuese" do të kuptohet paga bruto e muajit të fundit që zbatohet për atë funksion a detyrë në momentin e lindjes së të drejtës për përfitime shtetërore suplementare.

1. Paga bruto përbëhet nga:

- a) paga bazë e caktuar sipas tabelës së pagave;
- b) shtesa për funksion;
- c) shtesa për vjetërsi në punë; dhe
- d) shtesa për vështirësi në punë.

2. Drejtoria e Pagave pranë Ministrisë së Punës, Emigracionit, Përkrahjes Sociale dhe ish-të Përndjekurve Politikë përcakton pagën referuese të vendit të punës, kur në momentin e lindjes së të drejtës për përfitime shtetërore suplementare nuk ekziston funksioni a detyra që ka pasur personi, pra nuk ka pagë të miratuar.

III. Në zbatim të pikës 8, shkronja “b”, dhe të pikës 9, shkronjat “b”, “c” dhe “d”, të nenit 1 të ligjit të mësipërm, personat e barazuar me personat që janë në funksione dhe detyra përkatëse, përcaktohen në listën që i bashkëngjitet këtij vendimi.

IV. Në zbatim të nenit 4 të ligjit të mësipërm, krijohet fondi i përfitimeve shtetërore suplementare, i cili financohet:

- a) nga Buxheti i Shtetit;
- b) nga kontributi që derdhin personat e punësuar.

Buxheti i Shtetit përcakton çdo vit pjesën që do të financojë në këtë fond. Kjo pjesë do të jetë si diferencë ndërmjet përfitimeve shtetërore suplementare që jepen sipas këtij ligji dhe kontributit që derdhin personat e punësuar.

V. Në zbatim të nenit 6 të ligjit të mësipërm, punëdhënësi është i detyruar:

a) të mbajë nga paga bruto e të punësuarve kontributin e përcaktuar për këta persona në nenin 5 të këtij ligji; dhe

b) ta derdhë atë në llogarinë e fondit të përfitimeve shtetërore suplementare.

1. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe derdhjen e tyre.

2. Punëdhënësi detyrohet të paraqesë, brenda datës 30 të muajit pasardhës:

- a) listën e personave që përfitojnë nga ky ligj, funksionin a detyrën e tyre;
- b) pagën bruto;
- c) shumën e kontributeve të ndaluara, të rakorduara këto me shumën e derdhur në fondin e përfitimeve shtetërore suplementare.

VI. Në zbatim të nenit 7 të ligjit të mësipërm, shpërblimi do të jepet i menjëhershëm pas largimit nga funksioni a detyra.

1. Pas këtij shpërblimi do të vazhdojnë të marrin pagesën kalimtare:

a) në masën 50% të pagës referuese, duke filluar nga muaji i katërt, personat e paragrafit të parë të nenit 7;

b) në masën 50% të pagës referuese, duke filluar nga muaji i tretë, personat e paragrafit të dytë të nenit 7;

c) në masën 40% të pagës referuese, duke filluar nga muaji i tretë, personat e paragrafit të tretë të nenit 7.

Pagesa e mësipërme do të vazhdojë të jepet për një periudhë kohe jo më të gjatë se afatet e përcaktuara përkatësisht në nenin 7 të këtij ligji.

2.a) Personi nuk merr kompensimin mbi pagë, kur ai punësohet dhe paga e re është më e lartë se paga referuese.

b) Personi do të marrë kompensimin mbi pagë, deri në afate të përcaktuara në këtë nen, kur ai punësohet dhe paga e re është më e ulët se paga referuese. Ky kompensim nuk do të jetë më i lartë se 50% e pagës referuese, të përcaktuar në paragrafin e parë dhe të dytë të nenit 7 të ligjit dhe 40% e saj e përcaktuar në paragrafin e tretë.

3. Pagesat e shpërblimit të menjëhershëm bëhen nga punëdhënësi i fundit.

Për pagimin e shpërblimit të menjëhershëm, punëdhënësi i fundit kërkon nga Ministria e Financave mbulimin e efekteve financiare nga Buxheti i Shtetit.

4. Për pagesën kalimtare i interesuari do të paraqesë kërkesën pranë organit të sigurimeve shoqërore, bashkëlidhur së cilës do të ketë dhe këto dokumente:

a) vërtetim nga qendra e punës për largimin nga funksioni a detyra, si dhe vitet e shërbimit në këto funksione dhe detyra;

b) pagën referuese;

c) deklaratë nëse është i punësuar dhe pagën që merr, ose deklaratë që nuk është i punësuar. Kjo deklaratë do të jetë e përmuajshme.

5. Pagesa kalimtare caktohet nga organi i sigurimeve shoqërore dhe bëhet:

a) për personat, të cilët nuk janë të punësuar pranë organit financiar të përcaktuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore;

b) për personat e punësuar pranë qendrës së punës.

Për personat e pikës "b", pagesat rimburohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore nëpërmjet fondit të përfitimeve shtetërore suplementare.

VII. Në zbatim të neneve 9, 11, 13 dhe 14 të këtij ligji, masa e pensionit llogaritet dhe caktohet nga organi i sigurimeve shoqërore.

VIII. Në zbatim të nenit 21 të këtij ligji, për të përfituar pensione shtetërore suplementare, i interesuari do të paraqesë pranë organit të sigurimeve shoqërore dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesë për pension;

b) vërtetim nga qendra e punës për funksionet a detyrat e kryera, për të cilat i lind e drejta për pension, vitet e shërbimit për funksionin a detyrën;

c) vërtetimin e pagës për funksionin a detyrën;

d) procesverbalin nga qendra e punës, i cili është mbajtur për aksidentin në shërbim;

e) vendimin e komisionit mjekësor të caktimit të aftësisë për punë, se është deklaruar invalid i përhershëm nga aksidenti në shërbim;

f) certifikatën e gjendjes familjare;

g) certifikatën e vdekjes;

gj) dëshmi penaliteti.

IX. Në zbatim të nenit 24 të këtij ligji, ngrihet një komision i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili shqyrton dëshminë e penalitetit dhe vendos nëse personi ka të drejtë për të përfituar pension shtetëror suplementar.

X. Në Institutin e Sigurimeve Shoqërore të krijohet sektori i sigurimit suplementar për administrimin e kësaj skeme.

1. Për kryerjen e pagesave të përfitimeve që rrjedhin nga ky ligj, Institutit të Sigurimeve Shoqërore në planin e shpenzimeve të vitit 1996, i shtohen 14,2 milionë lekë, që përballohen nga fondi buxhetor i parashikuar për punët publike.

Për kryerjen e shpërblimeve të menjëhershme, që rrjedhin nga ky ligj, Ministrisë së Financave i shtohen 18.5 milionë lekë, të cilët përballohen nga fondi buxhetor i parashikuar për punët publike.

2. Shpenzimet administrative për funksionimin e kësaj skeme përballohen nga Buxheti i Shtetit. Për vitin 1996, në planin e shpenzimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore shtohen 5 milionë lekë.

XI. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për hartimin e udhëzimeve, rregullores dhe dokumentacionin për zbatimin e këtij vendimi.

Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore nxjerrin një udhëzim të përbashkët për mbledhjen e kontributeve dhe rakordimin e tyre me derdhjen e bërë në Fondin e Përfitimeve Shtetërore Suplementare.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga 1 prilli 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra nr.69, datë 24.9.2010

**LISTA PËR FUNKSIONET DHE DETYRAT TË CILAT MERREN PËR BAZË PËR PËRFITIME
SIPAS LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET SHTETËRORE
SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË
PUNONJËSVE TË SHTETIT”**

“Neni 1 pika 5 e ligjit”

Njihen vite shërbimi për efekt të këtij ligji puna e kryer nga 1.4.1991 e në vazhdim në funksionet dhe detyrat e mëposhtme:

Për grupin e parë germa “a”, pika 8, e nenit 1 të këtij ligji:

- Kryetari i Kryesisë së Kuvendit Popullor;
- Kryetari i Këshillit të Ministrave;
- Anëtarët e Këshillit të Ministrave;
- Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;
- Kryetari i Gjykatës së Kasacionit;
- Kryetari i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit;
- Prokurori i Përgjithshëm.

Personat e barazuar me anëtarët e Këshillit të Ministrave janë:

- Kryetari i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;
- Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave;
- Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës;
- Kryetari i Komitetit të ish-të Përndjekurve Politikë.

Për grupin e parë germa “b” e pikës 8 të nenit 1 të këtij ligji:

- Deputetët e Kuvendit Popullor;
- Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese;
- Anëtarët e Gjykatës së Kasacionit.

Për grupin e dytë germa “a” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji:

- Sekretarët e Shtetit;
- Zëvendësministrat;
- Zëvendësprokurorët e Përgjithshëm dhe personat e tjerë të barazuar me ta, si më poshtë;
- Sekretari i Përgjithshëm i Shërbimit të Kontrollit të Shtetit;

- Kryetari i Akademisë së Shkencave;
- Kryetari i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
- Drejtori i Përgjithshëm i RTV-së;
- Drejtori i ATSH-së;
- Zëvendëskryetar i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;
- Drejtor i Departamentit pranë Kryeministrit;
- Këshilltar i Kryeministrit;
- Shef i Kabinetit të Kryeministrit;
- Zëdhënës i Kryeministrit;
- Zëvendëskryetarët e Shërbimit të Kontrollit të Shtetit;
- Kryetari i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
- Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve;
- Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Drejtor i Përgjithshëm i Rezervave Shtetërore;
- Drejtor i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
- Drejtor i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor;
- Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Tatimeve;
- Këshilltar i Kryetarit të Kryesisë së Kuvendit Popullor;
- Zëdhënës i Kuvendit Popullor;
- Shef i Kabinetit të Kuvendit Popullor;
- Drejtor i Përgjithshëm i Doganave;
- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Financiare;
- Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Tatimore;
- Guvernator i Bankës së Shqipërisë;
- Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Kursimit;
- Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare;
- Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Tregtare Agrare;
- Prokuror i Gjykatës së Kasacionit;
- Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil;
- Shef i Kabinetit të Presidentit;
- Këshilltar i Presidentit;
- Zëdhënës i Presidentit;
- Prefekti;
- Kryetari i Këshillit të rrethit;
- Kryetari i Bashkisë.

Për grupin e dytë germa “b” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji:

- Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave;
- Sekretar shkencor në Akademinë e Shkencave;
- President i Komitetit Olimpik Shqiptar;
- Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
- Kryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
- Kryetar i Agjencisë së Privatizimit dhe Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore;
- Këshilltar i Zëvendëskryeministrit;
- Shef i Protokollit dhe Ceremonisë në Presidencë;
- Shef i Zyrës së Pritjes së Popullit në Presidencë;
- Kryeinspektor në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;
- Drejtor i Përgjithshëm në Ministri;
- Zëvendësdrejtor i përgjithshëm në RTV;
- Drejtor i Radios së Jashtme;
- Drejtor i Radios së Brendshme;
- Drejtor i Televizionit;
- Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shtetit;
- Kryetar i Qendrës për Nxitjen e Investimeve të Huaja;

- Kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve;
- Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
- Kryetar i Komitetit Shqiptar të Birësimeve;
- Zëvendëskryetar i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
- Drejtor i Përgjithshëm i Njësisë së Implementimit të Projektit Mobil;
- Shef i Shërbimit të Inspektoratit të Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave;
- Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshme të Aviacionit Civil;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Ministrive dhe Institucioneve Qendrore;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Drejtor i Ligjshmërisë në Gjykatën e Kasacionit;
- Drejtor i Përgjithshëm i ish-të Përndjekurve Politikë;
- Drejtor i Drejtorisë Kombëtare të Metrologjisë dhe Kalibrimit;
- Drejtor i Drejtorisë së Standardizimit dhe Cilësisë;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor;
- Përgjegjës i Sektorit në Presidencë;
- Sekretar i Presidentit;
- Kryetar i Komisionit Shtetëror trepalësh për dhënien e statusit të ish-të përndjekurve politikë;
- Drejtor i Agjencisë së Prokurimit Publik;
- Kryekëshilltar në Kryesinë e Kuvendit Popullor;
- Këshilltar i Komisionit në Kuvendin Popullor;
- Zëvendësdrejtor i ATSH-së;
- Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
- Zëvendëskryetar i Qendrës Shqiptare të Nxitjes së Investimeve të Huaja;
- Zëvendëskryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
- Sekretar i Përgjithshëm i Prefekturës së Tiranës;
- Zëvendësdrejtor i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
- Zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
- Zëvendëspresidentit i Komitetit Olimpik;
- Këshilltar;
- Drejtor Drejtorie për probleme të veçanta në Këshillin e Ministrave;
- Ndhmës i Kryetarit të Këshillit të Ministrave;
- Sekretar i Komitetit Olimpik Shqiptar;
- President i Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekut;
- Zëdhënës i Gjykatës së Kasacionit;
- Shef Kabineti të Ministrit;
- Sekretar i Kryetarit të Kuvendit Popullor;
- Sekretar i Kryeministrit;
- Kryetar i Gjykatës së Rrethit Tiranë;
- Drejtor Drejtorie (Prokuror) në Prokurorinë e Përgjithshme;
- Prokuror, hetues, oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme;
- Prokuror në Prokurorinë e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
- Zëvendësprokuror në Prokurorinë e rrethit;
- Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
- Kryetar në gjykatat e rretheve;
- Prokuror rrethi;
- Zëvendësprokuror rrethi;
- Zëvendëskryetar në gjykatat e rretheve.

Për grupin e dytë germa “c” e nenit 9 të këtij ligji:

- Drejtor drejtorie në Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;

- Zëvendës drejtor në Ministri, Institucione dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;
 - Ambasador i Republikës së Shqipërisë;
 - Shef sektori në Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;
 - Konsull në konsullatat e Republikës së Shqipërisë;
 - Kryetar dege në ministri, institucione qendrore dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit.
- Për grupin e dytë germa “d” e nenit 9 të këtij ligji:
- Specialist në ministri, institucione qendrore dhe në Shërbimin e Kontrollit të Shtetit;
 - Gjyqtar në gjykatat e rretheve;
 - Prokuror;
 - Hetues, Oficer i Policisë Gjyqësore.

Shënim. Periudha që punonjësit ushtarakë përfitojnë nga ligji nr.8087, datë 13.3.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” përjashtohet.

VENDIM
Nr.808, datë 24.12.1998

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË VENDIMET E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR. 396, DATË 26.9.1997, NR. 335, DATË 2.9.1997 DHE NR. 382, DATË 20.5.1996

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 2, të ligjit nr. 8215, datë 9.5.1997 “Për kontrollin financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Koordinimit Qeveritar, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 26.9.1997 “Për detyrat e grupit të mbikëqyrjes të kontrollit financiar të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, bëhen këto ndryshime:

Në pikën 5, shtohet ky paragraf, me këtë përmbajtje:

“Fondi i pagave dhe i shpenzimeve administrative, që kryhen për llogari të Grupit Mbikëqyrës, të parashikohen si zë i veçantë në buxhet brenda buxhetit të Kryeministritë.”

Pas pikës 5, shtohet pika 5/1, me këtë përmbajtje:

“Përpunimi i dokumentacionit financiar të shoqërive huamarrëse dhe përgatitja e regjistrave për rishpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve, kryhet pranë Qendrës së Informatizimit Financiar.

Shpenzimet e përpunimit të deklaratave të kreditorëve përballohen me të ardhurat që sigurohen nga shitja e tyre kreditorëve.

Për llogaritjen e borxhit të shoqërive huamarrëse shpenzimet mbulohen nga buxheti i shtetit dhe caktohen si zë i veçantë në shpenzimet e Grupit Mbikëqyrës”.

2. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 355, datë 2.9.1997 “Për lëshimin e pasaportave diplomatike dhe të shërbimit”, në pikën 3 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kryetari i Grupit Mbikëqyrës për kontrollin e shoqërive huamarrëse”.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 20.5.1996 “Për zbatimin e ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore, suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit””, në listën për grupin e dytë germa “A”, në pikën 9, të nenit 1 të këtij ligji, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kryetari i Grupit Mbikëqyrës për kontrollin e shoqërive huamarrëse”.

4. Anëtarët e Grupit Mbikëqyrës barazohen në trajtim me zëvendësministrat dhe gëzojnë të gjitha të drejtat e përfituara nga ana e tyre.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko

Botuar në Fletoren Zyrtare ekstra Maj, datë 31.5.2000

VENDIM
Nr.499, datë 21.9.2000

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996,
PËR PENSIONET SHETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE, QË KRYEJNË
FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHETËTIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 29, të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.382, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, lista e përcaktuar në pikat I dhe III ndryshohet dhe bëhet sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Funksionet kushtetuese dhe detyrat në administratën publike, që përfshihen për herë të parë në grupimet përkatëse, do të derdhin, sipas këtij vendimi, në fondin e sigurimit shtetëror suplementar, kontributin e sigurimit shtetëror suplementar në përqindjet e caktuara në ligj, prej datës së emërimit të tyre në detyrë e në vazhdim.

3. Të gjitha institucionet, që përfshihen në skemën e sigurimit suplementar, sipas ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, duhet t’i përmbahen emërtimeve të përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet listëpagesës që dorëzojnë pranë organeve të sigurimeve shoqërore.

4. Për çdo ndryshim të emërtimeve ose krijimit të emërtimeve të reja nga lista e miratuar, subjektet e interesuara duhet t’i paraqesin ndryshimet e tyre pranë Këshillit të Ministrave për miratim, në rast të kundërt organet e sigurimeve shoqërore nuk do të marrin parasysh kontributet e derdhura për emërimet jashtë listës.

5. Në vendimin nr.382, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, pika II/2 e vendimit të ndryshohet si vijon:

“Departamenti i Administratës Publike, pranë Këshillit të Ministrave, përcakton pagën referuese të vendit të punës, kur në çastin e lindjes të së drejtës përfitime shtetërore suplementare nuk përmendet funksioni apo detyra që ka patur personi, pra nuk ka pagë të miratuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Illir Meta

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.32, datë 23.10.2000

LISTA PËR FUNKSIONET DHE DETYRAT TË CILAT MERREN PËR BAZË PËR PËRFITIME
SIPAS LIGJIT NR.8500, DATË 10.06.1999 PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8097,
DATË 21.03.1996, “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË
KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”

Për grupin e parë germa “a”, pika 8, e nenit 1, të këtij ligji:

President i Republikës së Shqipërisë

Kryetari i Kuvendit;

Kryeministër;

Zëvendëskryeministër;

Anëtarët e Këshillit të Ministrave;

Zëvendëskryetari i Kryesisë së Kuvendit;

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;

Personat e barazuar me anëtarët e Këshillit të Ministrave janë:

Kryetari i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;

Kryetari i Gjykatës së Lartë;

Kryetari i Komitetit të Ish-të Përndjekurve Politikë;

Prokuror i Përgjithshëm;

Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Kryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror;

Kryetar i Komitetit Kombëtar të R.T.V.

Për grupin e parë germa “b”, e pikës 8, të nenit 1, të këtij ligji:

Deputetët e Kuvendit;

Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese;

Anëtarët e Gjykatës së Lartë;

Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

Avokati i Popullit

Për grupin e dytë germa “a”, e pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji:

Sekretarët e Shtetit;

Zëvendësministrat;

Zëvendësprokurorët e Përgjithshëm;

dhe personat e tjerë të barazuar me ta si më poshtë:

Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit;

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave;

Sekretari i Përgjithshëm i Presidencës;

Komisioner në Avokatin e Popullit;

Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të R.T.V.;

Kryetari i Akademisë së Shkencave;

Kryetar i Komitetit të Zhvillimit dhe Turizmit;

Kryetari i Komitetit Kombëtar të Energjisë;

Sekretari i Përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Drejtori i Përgjithshëm i R.T.V.-së;

Drejtori i A.T.Sh-së;

Zëvendëskryetar i Komitetit të Shkencës dhe Teknologjisë;

Drejtor i Departamentit pranë Kryeministrisë;

Këshilltar i Kryeministrit;

Shef i Kabinetit të Kryeministrit;

Zëdhënësi i Kryeministrit;

Zëvendëskryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

Zëvendëskryetari i Shërbimit Informativ Shtetëror;

Kryetari i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;

Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;

Drejtori i Përgjithshëm i Rezervave Shtetërore;

Drejtori i Agjencisë Kombëtare të Privatizimit;
 Drejtori i Agjencisë së Prokurimit Publik;
 Drejtori i Drejtorisë Qendrore të Shërbimit Qeveritar;
 Drejtori i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor;
 Drejtor i Përgjithshëm i Drejtorisë së Tatimeve;
 Këshilltar i Krytarit të Kuvendit;
 Zëdhënës i Kuvendit;
 Shef i Kabinetit të Kuvendit;
 Drejtor i Përgjithshëm i Doganave;
 Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Financiare;
 Drejtor i Përgjithshëm i Policisë Tatimore;
 Guvernatori i Bankës së Shqipërisë;
 Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Kursimit;
 Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Kombëtare Tregtare;
 Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Tregtare Agrare;
 Kancelar i Gjykatës së Lartë;
 Prokuror i Gjykatës së Lartë;
 Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil;
 Shef i Kabinetit të Presidentit;
 Këshilltar i Presidentit;
 Zëdhënës i Presidentit;
 Prefekti;
 Kryetari i këshillit të rrethit;
 Kryetari i këshillit të qarkut;
 Kryetari i Bashkisë;
 Sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese;
 Ndihmës i Kryeministrit;
 Kryetar i Komitetit Shtetëror për Kontrollin e Figurave të Zyrtarëve;
 Kryekoordinator në Departamentin e Koordinimit në Këshillin e Ministrave;
 Kryetari i Grupit Mbikqyrjes të Shoqërive Huamarrëse;
 Ndihmës i Zv/Kryeministrit;
 Sekretar i Përgjithshëm në Prefekturë;
 Sekretar i Përgjithshëm në Këshillat e Rretheve;
 Sekretar i Përgjithshëm në Këshillin e Qarkut;
 Sekretar i Përgjithshëm në Bashki;
 Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Integritimit të Përndjekurve Politikë;
 Inspektor i Përgjithshëm i SHIK-ut;
 Sekretar i Përgjithshëm në Ministri.
 Për grupin e dytë germa “b” e pikës 9 të nenit I të këtij ligji:
 Zëvendëskryetari i Akademisë së Shkencave;
 Zëvendëskryetar i Komitetit të Zhvillimit të Turizmit;
 Sekretar Shkencor në Akademinë e Shkencave;
 President i Komitetit Olimpik Shqiptar;
 Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të Energjisë;
 Kryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
 Kryetar i Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve Bujqësore;
 Këshilltar i Zëvendëskryeministrit;
 Shef i protokollit dhe ceremonisë në Presidencë;
 Shef i zyrës së pritjes së popullit në Presidencë;
 Kryeinspektor në Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Drejtor i Përgjithshëm në Ministri;
 Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm në R.T.V;
 Drejtor i Radios së Jashtme;

Drejtor i Radios së Brendshme;
 Drejtor i Televizionit;
 Drejtor i Përgjithshëm i Arkivave të Shtetit;
 Kryetar i Qendrës për Nxitjen e Investimeve të Huaja;
 Kryetar i Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit;
 Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve;
 Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
 Kryetar i Komitetit Shqiptar të Birësimeve;
 Zëvendëskryetar i Komisionit Shtetëror të Kthimit të Pronave;
 Drejtor i Përgjithshëm i Njësisë së Implementimit të Projektit Mobil;
 Shef i Shërbimit të Inspektoriatit të Përgjithshëm Financiar në Ministrinë e Financave;
 Drejtor në Drejtorinë e Përgjithshëm të Aviacionit Civil;
 Zëvendësdrejtorët e Përgjithshëm të Ministrive dhe Institucioneve Qendrore;
 Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve;
 Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
 Drejtor i Ligjshmërisë në Gjykatën e Kasacionit;
 Drejtor i Përgjithshëm i ish-të Përndjekurve Politikë;
 Drejtor i Drejtorisë Kombëtare të Meteorologjisë dhe Kalibrimit;
 Drejtor i Drejtorisë së Standartizimit dhe Cilësisë;
 Drejtor i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë;
 Drejtor i Inspektimit në Ministrinë e Drejtësisë;
 Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor;
 Përgjegjës i Sektorit në Presidencë;
 Sekretar i Presidentit;
 Kryetar i Komisionit Shtetëror trepalësh për dhënien e Statusit të Ish-të Përndjekurve Politikë;
 Kryekëshilltar në Kuvend;
 Këshilltar Komisioni në Kuvend;
 Zëvendësdrejtor i A.T.Sh-së;
 Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikës;
 Zëvendëskryetar i Qendrës Shqiptare të Nxitjes së Investimeve të Huaja;
 Zëvendëskryetar i Agjensisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve;
 Zëvendësdrejtor i Agjensisë Kombëtare të Privatizimit;
 Zëvendësdrejtor i Agjensisë së Prokurimit Publik;
 Zëvendësdrejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave;
 Zëvendëspresident i Komitetit Olimpik;
 Këshilltar në Ministri dhe Institucione Qendrore;
 Drejtor Drejtorie (për probleme të veçanta) në Këshillin e Ministrave, Presidencë dhe Kuvend;
 Sekretar i Komitetit Olimpik Shqiptar;
 President i Këshillit Kombëtar të Urdhërit të Mjekut;
 Zëdhënës i Gjykatës së lartë;
 Shef Kabineti në Ministri dhe Institucione Qendrore;
 Drejtor i Përgjithshëm i Administratës së Përgjithshme të Ndhmës dhe Çështjeve Sociale;
 Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Kombëtar të Punësimit;
 Drejtor i Përgjithshëm i Inspektoriatit të Punës;
 Koordinator në Këshillin e Ministrave;
 Drejtor i Përgjithshëm i Pyjeve dhe Kullotave;
 Kryeinspektor i Inspektoriatit Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tij;
 Drejtor Drejtorie (Prokuror) në Prokurorinë e Përgjithshme;
 Prokuror, Hetues, Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme;
 Prokuror në prokurorinë e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;

Zëvendësprokuror në Prokurorinë e Rrethit;
 Gjyqtar në Gjykatën e Apelit Civil dhe Ushtarak në Tiranë;
 Kryetar në Gjykatat e rretheve;
 Kryetar i Gjykatës së Apelit në rrethe;
 Prokuror rrethi;
 Zëvendësprokuror Rrethi;
 Zëvendëskryetar në Gjykatat e Rretheve;
 Zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit në Rrethe;
 Inspektor i Kontroll-Bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave;
 Për grupin e dytë germa "c" e pikës 9 të nenit 1, të këtij ligji:
 Drejtor Drejtorie në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Zëvendësdrejtor në Këshill të Ministrave, Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Ambasador i Republikës së Shqipërisë;
 Ministër Fuqplotë në Ambasadë;
 Shef sektori në Këshill të Ministrave, Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Konsull në Konsullatat e Republikës së Shqipërisë;
 Kryetar dege në Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Ministër Këshilltar në Ambasadë;
 Këshilltar në Ambasadë;
 Sekretar i Parë në Ambasadë;
 Sekretar i Dytë në Ambasadë;
 Sekretar i Tretë në Ambasadë.
 Për grupin e dytë germa "d" e nenit 9 të këtij ligji:
 Specialist në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, Ministri, Institucione Qendrore dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit;
 Gjyqtarë në Gjykatatat e Rretheve;
 Prokurorë;
 Hetues, oficer i Policisë gjyqësore;
 Gjyqtarë në Gjykatat e Apelit;
 Prokuror në Prokurorinë e Apelit;
 Sekretar i Kryetarit të Kuvendit;
 Sekretar i Kryeministrit;
 Atashe në Ambasadë;
 Asistent i Inspektorit të Kontroll - Bashkërendimit në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ në Këshillin e Ministrave.
 Shënim:
 1. Periudha që punonjësit ushtarakë përfitojnë nga ligji nr.8087, datë 13.3.1996 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" përjashtohet.

VENDIM
Nr.120, datë 8.3.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996, "PËR PENSIONET SHTETËRORE, SUPLEMENTARE, TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të parë të nenit 29 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar me ligjin nr.8500, datë 10.6.1999, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën që i bashkëlidhet vendimit nr.382, datë 20.5.1996, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar me vendimin nr.499, datë 21.9.2000 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nëntitullin "Për grupin e parë, germa "a" të pikës 8 të nenit 1 të këtij ligji", në paragrafin "personat e barazuar me anëtarët e Këshillit të Ministrave", bëhen këto ndryshime:

a) Emërtimi "Kryetar i Komitetit Kombëtar të RTV" zëvendësohet me emërtimin "Kryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit";

b) Pas emërtimit "Kryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit" shtohet emërtimi "Guvernator i Bankës së Shqipërisë";

2. Në nëntitullin "Për grupin e dytë, germa "a" të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji" në paragrafin "dhe personat e tjerë, të barazuar me ta, si më poshtë", bëhen këto ndryshime:

a) Emërtimi "Zëvendëskryetar i Komitetit Kombëtar të RTV" zëvendësohet me emërtimin "Zëvendëskryetar i Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit";

b) Emërtimi "Guvernator i Bankës së Shqipërisë", zëvendësohet me emërtimin "Zëvendësguvernator i Bankës së Shqipërisë";

c) Pas emërtimit "Zëvendësguvernator i Bankës së Shqipërisë", shtohet emërtimi "Inspektor i Përgjithshëm në Bankën e Shqipërisë";

ç) Pas emërtimit "Kryetar i Gjykatës së Apelit Civil" shtohet emërtimi "Kryeinspektor i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

3. Në nëntitullin "Për grupin e dytë, germa "b" të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji", bëhen këto shtesa:

a) Pas emërtimit "Gjyqtar në Gjykatën e Apelit, Civil dhe Ushtarak, në Tiranë", shtohet emërtimi "Zëvendëskryeinspektor dhe inspektor i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë";

b) Pas emërtimit "Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i RTV", shtohet emërtimi "Drejtor Departamenti në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit", si dhe emërtimi "Kryetar i Këshillit të Ankesave, në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit".

4. Në nëntitullin "Për grupin e dytë, germa "d", të nenit 9 të këtij ligji, pas fjalëve "specialist në Presidencë, Kuvend, Këshill të Ministrave, ministri, institucione qendore dhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit" shtohen fjalët "dhe në Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

5. Efektet financiare, në zbatim të këtij vendimi, fillojnë nga data e emërimit të secilit punonjës në detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Illir Meta

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.10, datë 2.4.2001

VENDIM
Nr.296, datë 8.5.2003

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET
SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE
KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT”“

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9 të nenit 1 e të paragrafit të parë të nenit 29 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën që i bashkëlidhet vendimin nr.382, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:

1. Në titullin “Për grupin e dytë, shkronja “a” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, në paragrafin “dhe persona të tjerë, të barazuar me ta, si më poshtë”, të shtohen emërtimet:

“Sekretar i Përgjithshëm i Avokaturës së Shtetit;
Avokat i Shtetit në Avokaturën e Përgjithshme;
Drejtor i kabinetit të Zëvendëskryeministrit;
Këshilltar i Zëvendëskryeministrit;
Ndihmës i Presidentit;
Anëtar i Komisionit të Shërbimit Civil.”.

2. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “b” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, të hiqet emërtimi “Këshilltar i Zëvendëskryeministrit” dhe të shtohen emërtimet “Shef kabineti i Avokatit të Përgjithshëm të Avokaturës së Shtetit” dhe “Avokat shteti pranë Gjykatës së Apelit, në zyrat vendore”.

3. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “c” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, të shtohen emërtimet:

“Ndihmës i këshilltarit të Presidentit;
Zëvendëskryetar i këshillit të qarkut;
Jurist në Departamentin Juridik në Kryeministri.”.

4. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “d” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, të shtohen emërtimet:

“Sekretar i Sekretarit të Përgjithshëm në Presidencë;
Sekretar i shefit të kabinetit në Presidencë;
Sekretar i këshilltarit të Presidentit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare që nga data e derdhjes së kontributeve.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.43, datë 3.5.2003

VENDIM
Nr. 467, datë 23.6.2005

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE, QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE, DHE TE PUNONJËSVE TË SHTETIT””, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, pikat 5 e 9, dhe 29 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese, dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.382, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

I. Paragrafi i parë i kreut III numërohet 1 dhe pas tij shtohen pikat e mëposhtme, me këtë përmbajtje:

“2. Institucionet, që përfshihen në skemën e sigurimit shtetëror suplementar, në listëpagesën që dorëzojnë pranë organeve të sigurimeve shoqërore, duhet t’u përmbahen emërtimeve të përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Për çdo ndryshim të emërtimeve ose për çdo krijim të një emërtimi të ri, që nuk përfshihet në listën e miratuar, subjektet e interesuara duhet t’i miratojnë ndryshimet në Këshillin e Ministrave. Në të kundërt organet e sigurimeve shoqërore nuk marrin parasysh kontributet e derdhura për to.

4. Personat, që kryejnë funksione kushtetuese, dhe punonjësit e administratës publike, që do të përfshihen për herë të parë në listë apo që janë të përfshirë, por ndryshojnë grupimet përkatëse, të përcaktuara në listën, që i bashkëlidhet vendimit, të derdhen kontributin e sigurimit shtetëror suplementar në përqindjen e caktuar në ligj, prej datës së emërimit të tyre në detyrë e në vazhdim.”.

II. Në listën, që i bashkëlidhet vendimit, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “a” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, në paragrafin “. . . dhe persona të tjerë, të barazuar me ta si më poshtë:”, të bëhen shtesat si më poshtë vijon:

“- Drejtor i kabinetit të Avokatit të Popullit;

- Sekretar i Përgjithshëm i institucionit të Avokatit të Popullit;

- Drejtor i kabinetit të Avokatit të Përgjithshëm të Avokaturës së Shtetit;

- Drejtor i kabinetit të Inspektorit të Përgjithshëm në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;

- Inspektor i lartë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;

- Kryetar i njësisë bashkiake të Tiranës;

- Drejtor i kabinetit të kryetarit të Komisionit të Shërbimit Civil;

- Sekretar i Përgjithshëm i Komisionit të Shërbimit Civil;

- Drejtor i kabinetit në ministri dhe institucione qendrore.”.

2. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “b” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, të bëhen ndryshimet e shtesat si më poshtë vijon:

a) Të hiqet emërtimi “Shef i kabinetit në ministri dhe institucione qendrore”;

b) Të shtohen këto emërtesa:

“Këshilltar i Avokatit të Popullit;

Kryetar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;

Gjyqtar i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda;

Drejtuues i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda;

Prokuror i Prokurorisë së Apelit për Krime të Rënda;

Kryetar i Gjykatës për Krime të Rënda;
Drejtues i Prokurorisë për Krime të Rënda;
Zëdhënës i ministrit.”.

c) Të hiqet emërtimi “Shef kabineti i Avokatit të Përgjithshëm të Avokaturës së Shtetit”.

3. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “c” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, të bëhen shtesat si më poshtë vijon:

a) Pas emërtesave “drejtor drejtorie në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë”, të shtohen edhe “...në institucionin e Avokaturës së Shtetit, në institucionin e Avokatit të Popullit, në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në Komisionin e Shërbimit Civil.”.

b) Në fund të këtij nëntitulli të shtohen emërtimet e mëposhtme:

“Nënprefekti;

Ndihmësinjektor i lartë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive;

Ndihmëskomisioner i komisionerit të Avokatit të Popullit;

Gjyqtar i Gjykatës për Krime të Rënda;

Prokuror i Prokurorisë për Krime të Rënda;

Oficer i Policisë Gjyqësore në Prokurorinë për Krime të Rënda.”.

4. Në nëntitullin “Për grupin e dytë, shkronja “d” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, pas emërtesave “specialist në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore, në Kontrollin e Lartë të Shtetit, Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, shtohen edhe “. . . në institucionin e Avokaturës së Shtetit, në institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në Komisionin e Shërbimit Civil.”.

III. Pikat 2, 3 e 4 të vendimit nr.499, datë 21.9.2000 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.382, datë 20.5.1996 “Për zbatimin e ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese, dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.56, datë 5.7.2005

VENDIM

Nr.347, datë 19.3.2008

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE, QË KRYEJNË FUNKSIONE KUSHTETUESE, DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT””, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të parë të nenit 29 të ligjit nr.8097, datë 20.5.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese, dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën, që i bashkëlidhet vendimit nr.382, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Në nëntitullin “Për grupin e dytë”, shkronja “a” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji, në paragrafin “...dhe persona të tjerë, të barazuar me ta, si më poshtë:”, bëhen këto shtesa:

- “- Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës;
- Anëtar i Komisionit të Konkurrencës të Autoritetit të Konkurrencës;
- Avokat i Prokurimeve;
- Kryeinspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë;
- Shef kabineti në Gjykatën Kushtetuese;
- Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave;
- Anëtar i Grupit Mbikëqyrës të Shoqërive Huamarrëse.”.

2. Në nëntitullin “Për grupin e dytë”, shkronja “b” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji, të bëhen këto shtesa:

- “- Inspektor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë;
- Këshilltar në Gjykatën Kushtetuese;
- Zëvendës drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.”.

3. Në nëntitullin “Për grupin e dytë”, shkronja “c” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji, të bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve “...drejtor drejtorie në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, institucionin e Avokaturës së Shtetit, institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Komisionin e Shërbimit Civil.”, shtohen “...Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese.”.

b) Pas fjalëve “...shef sektori në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, institucionin e Avokaturës së Shtetit, institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Komisionin e Shërbimit Civil.”, shtohen “...Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese.”.

4. Në nëntitullin “Për grupin e dytë”, shkronja “d” e pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji, të bëhen këto shtesa:

a) Pas fjalëve “...specialist në Presidencë, Kuvend, Këshillin e Ministrave, ministri, institucione qendrore buxhetore, Kontrollin e Lartë të Shtetit, Këshillin e Lartë të Drejtësisë, institucionin e Avokaturës së Shtetit, institucionin e Avokatit të Popullit, Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Komisionin e Shërbimit Civil.”, shtohen “...Autoritetin e Konkurrencës, Avokatin e Prokurimeve dhe Gjykatën Kushtetuese.”, si dhe emërtimet e mëposhtme:

- “- Anëtar i Komitetit Shtetëror të Kulteve;
- sekretar i kryetarit të Gjykatës Kushtetuese;
- ndihmës ligjor në Gjykatën e Lartë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.50, datë 11.4.2008

VENDIM
Nr.641, datë 11.6.2009

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.382, DATË 20.5.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.8097, DATË 21.3.1996 “PËR PENSIONET
SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PERSONAVE, QË KRYEJNË FUNKSIONE
KUSHTETUESE, DHE TË PUNONJËSVE TË SHTETIT””, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të parë të nenit 29 të ligjit nr.8097, datë 21.3.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave, që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në nëntitullin “Për grupin e dytë, të shkronjës “b”, të pikës 9 të nenit 1 të këtij ligji”, të listës, që i bashkëlidhet vendimit nr.382, datë 20.5.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet emërtesa “Sekretar i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.106, datë 11.7.2009

LIGJ
Nr.10 139, datë 15.5.2009

**PËR PENSIONET SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË PUNONJËSVE TË
UNIVERSITETEVE, TË SHKOLLAVE TË LARTA, QENDRËS SË STUDIMEVE
ALBANOLOGJIKE, AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË GJITHA INSTITUCIONEVE
TË TJERA KËRKIMORE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË CILËT KANË
TITUJ SHKENCORË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është që personave të grupit të parë dhe të dytë, sipas përcaktimit në nenin 2 të këtij ligji, t'u jepen pensione suplementare shtetërore, si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime;

1. “Pensione suplementare” janë përfitimet që jepen sipas këtij ligji.
2. “Kontribut suplementar” është kontributi që paguhet sipas këtij ligji.
3. “Periudhë e ushtrimit të titullit” është:

a) Periudha deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, gjatë së cilës personat kanë gëzuar titullin shkencor “Profesor”, “Profesor i asociuar” (“Drejtues kërkimesh”, “Mjeshtër kërkimesh”), sipas vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

b) Periudha pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, gjatë së cilës personat kanë gëzuar titullin shkencor “Profesor”, “Drejtues kërkimesh”, “Profesor i asociuar”, “Mjeshtër kërkimesh”, sipas vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës dhe kanë derdhur kontribut suplementar, duke qenë në marrëdhënie pune me universitetet, shkollat e larta, Qendrën e Studimeve Albanologjike, Akademinë e Shkencave dhe me të gjitha institucionet e tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë.

4. “Pagë referuese” është paga bazë për titullin, përjashtuar shtesat për funksion. Për efekt të përcaktimit të përfitimeve, paga referuese llogaritet si mesatare e pagave referuese, sipas viteve të ushtrimit të titullit.

5. “Grupi i parë” janë profesorët dhe drejtues kërkimesh, të cilët kanë periudhë ushtrimi të titullit, sipas pikës 3 të këtij neni.

6. “Grupi i dytë” janë “Profesorë të asociuar” dhe “Mjeshtër kërkimesh”, të cilët kanë periudhë ushtrimi të titullit, sipas pikës 3 të këtij neni.

Neni 3
Financimi

Përfitimet shtetërore suplementare, që jepen sipas këtij ligji, financohen nga:

- a) Buxheti i Shtetit;
- b) kontributi suplementar.

Neni 4
Masa e kontributeve

Kontributet suplementare që paguhen në fondin e sigurimit suplementar shtetëror, janë:

- a) 3,5 për qind e pagës bruto mujore, për të punësuarit në institucione publike;
- b) 7 për qind e pagës bruto mujore, për të punësuarit në institucione jopublike.

Institucionet jopublike, ku punësimi vlerësohet periudhë e ushtrimit të titullit, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 5
Pagesa e kontributeve

Afati i derdhjes së kontributeve është jo më vonë se data e fundit e muajit pasardhës.

KREU II
PENSIONE SUPLEMENTARE PLEQËRIE

Neni 6
Kushti i përfitimit

Kushti për të përfituar pension suplementar shtetëror, sipas këtij ligji, është që personat, të cilët përfshihen në grupin e parë dhe të dytë të pikave 5 dhe 6 të nenit 2, të plotësojnë kriteret për marrjen e pensionit të pleqërisë, sipas ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 7
Masa e pensionit

1. Masa e pensionit suplementar është 1,3 për qind e pagës referuese për çdo periudhë njëvjeçare të ushtrimit të titullit “profesor” dhe 1,1 për qind e pagës referuese për çdo periudhë njëvjeçare të ushtrimit të titullit “Asistent profesor”.

2. Shuma e këtij pensioni suplementar, bashkë me përfitimet nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk mund të jetë më e madhe se 4 pensione bazë pleqërie, sipas përcaktimeve të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993.

3. Masa e pensionit suplementar nuk mund të jetë në asnjë rast më e vogël se 6 për qind e pagës referuese.

4. Masa e pensionit suplementar fillestar, për personat që nuk kanë kontribuar, nuk mund të jetë më shumë se 50 për qind e pensionit të pleqërisë, të përfituar sipas ligjit nr.7703, date 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Neni 8
Indeksi dhe rritja e pensionit

Indeksi dhe/ose rritja e pensioneve përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

**KREU III
DISPOZITA TË PËRBASHKËTA**

Neni 9

Kur periudha e ushtrimit të titullit nuk është e plotë në vite, për efekt llogaritjeje të masës së përfitimit, koeficienti në përqindje mbi pagën referuese, sipas nenit 7 të këtij ligji, llogaritet për çdo muaj.

Neni 10

1. E drejta për pension suplementar nuk parashkruhet.
2. Personit, që kërkon pensionin suplementar brenda 1 viti nga data që i ka lindur e drejta, i jepet ky pension që nga ajo datë. Në raste të tjera, pensioni paguhet nga data e regjistrimit të kërkesës.

Neni 11

Pensionet suplementare për titujt shkencorë administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, kundrejt një komisioni, që paguhet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 12

Përfitimet suplementare për titujt shkencorë jepen me kërkesën e të interesuarit, i cili paraqet dokumentacionin përkatës. Kërkesa për përfitim paraqitet pranë agjencive vendore të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Dokumentet, që i bashkëlidhen kërkesës dhe forma e tyre përcaktohen me akte nënligjore.

Neni 13

Llogaritja, caktimi dhe pagesa e përfitimeve suplementare bëhen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore. Buxheti i Shtetit cakton çdo vit fondet e nevojshme pranë buxhetit të institutit. Procedurat e zbatimit të buxhetit për këtë qëllim ndjekin të njëjtat rregulla dhe afate si ato të Buxhetit të Shtetit.

KREU IV
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 14

Personat, që kanë të drejtë për më shumë se 1 (një) lloj përfitimi nga ky ligj dhe nga ligje të tjera, si rrjedhojë e periudhave të ushtrimit të titullit, kanë të drejtë të zgjedhin përfitimin më të favorshëm.

Neni 15

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore të parashikuara nga nenet 4 e 11 të këtij ligji.
2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij ligji.

Neni 16

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2010.

**Shpallur me dekretin nr.6197, datë 5.6.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Botuar në Fletoren Zyrtare nr.87, datë 12.6.2009